



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/123

Datë: 05.04.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 14 të Rregullores nr.05/2013 për ndërmjetësim të kontesteve në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2013, mori:

V E N D I M

1. Emërohen ndërmjetësues për çështjet nga e Drejta e Autorit, përkitazi me kontestet lidhur me marrëveshjet gjithëpërfshirëse të parapara me nenin 176 të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, personat në vijim:
 - 1.1. Ilir Gaxha, ndërmjetësues;
 - 1.2. Mentor Hajdaraj, ndërmjetësues;
 - 1.3. Besim Kajtazi, ndërmjetësues;
 - 1.4. Albana Tigani, ndërmjetësues;
 - 1.5. Destan Bujupi, ndërmjetësues;
 - 1.6. Isuf Jahëmurataj, ndërmjetësues dhe
 - 1.7. Faton Morina, ndërmjetësues.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/123

Datë: 05.04.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Deklarata e Politikave Afatmesme Prioritare për vitin 2014-2016.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e deklaratës nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/123

Datë: 05.04.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2013, mori:

V E N D I M

1. Themelohet Grupi i punës për avancimin e politikës së punësimit për komunitetet të cilin do ta drejtojë Zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës dhe ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal, Slobodan Petrovic, në këtë përbërje:
 - 1.1. Srdjan Popovic-Këshilltar i lartë i Kryeministrit-Drejtor i Zyrës për çështje të komuniteteve-ZKM;
 - 1.2. Përfaqësuesi i ZPS-ZKM;
 - 1.3. Përfaqësuesi i SKQ-ZKM;
 - 1.4. Përfaqësuesi i Zyrës Ligjore-ZKM;
 - 1.5. Përfaqësuesi i Ministrisë së Administratës Publike;
 - 1.6. Përfaqësuesi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - 1.7. Përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve të Brendshme;
 - 1.8. Përfaqësuesi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal;
 - 1.9. Përfaqësuesi Ministrisë së Drejtësisë;
 - 1.10. Përfaqësuesi i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim;
 - 1.11. Përfaqësuesi i Policisë së Kosovës;
 - 1.12. Përfaqësuesi i Agjencisë së Statistikave të Kosovës;
 - 1.13. Përfaqësuesi i Doganave të Kosovës;
 - 1.14. Përfaqësuesi i Hekurudhave të Kosovës;
 - 1.15. Përfaqësuesi i Korporatës Energjetike të Kosovës dhe
 - 1.16. Përfaqësuesi i Post-Telekomit të Kosovës;
2. Ftohen të marrin pjesë me nga një përfaqësues (anëtar):

- 2.1. Përfaqësuesi i Këshillit konsultativ për komunitete;
 - 2.2. Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit;
 - 2.3. Përfaqësuesi i Kuvendit;
 - 2.4. Përfaqësuesi i Asociacionit të Komunave të Kosovës;
 - 2.5. Përfaqësuesi i Radio Televizionit të Kosovës dhe
 - 2.6. Përfaqësuesi i Agjencisë Kundër Korrupsionit.
3. Në cilësinë e ekspertëve dhe të ndihmës së jashtme ftohen:
- 3.1. Përfaqësuesi i Ambasadës së SHBA-së në Kosovë;
 - 3.2. Përfaqësuesi i Ambasadës së Norvegjisë në Kosovë;
 - 3.3. Përfaqësuesi i Ambasadës së Britanisë së Madhe në Kosovë;
 - 3.4. Përfaqësuesi i Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë;
 - 3.5. Përfaqësuesi i Ambasadës së Zvicrës në Kosovë;
 - 3.6. Përfaqësuesi i Misionit të OSBE-së në Kosovë;
 - 3.7. Përfaqësuesi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë/Përfaqësuesit special të BE-së;
 - 3.8. Përfaqësuesi i Programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara;
 - 3.9. Përfaqësuesi i Qendrës Evropiane për Çështje të Pakicave.
4. Me qëllim të përparimit në zbatimin e ligjeve të cilat rregullojnë punësimin e komuniteteve jo shumicë, grupi i punës do të përgatit rekomandime, masa dhe direktiva të tjera të nevojshme për fuqizimin dhe rritjen e kapaciteteve të efikasitetit të mekanizmave që rregullojnë punësimin e komuniteteve jo shumicë në pajtim me ligjin.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/123

Datë: 05.04.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Implementimin e Standardit për Klasifikimin e Veprimtarive Ekonomike në Versionin NACE-Rev.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/123

Datë: 05.04.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2013, mori:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 40,000.00 (dyzet mijë) euro, për përmbushjen e kontributit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2012 në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal, me seli në Sarajevë, respektivisht në buxhetin e Sekretariatit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal (RCC) e cila shumë formalisht është vendosur në Takimin e Tryezës Rajonale të Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore në Bukuresht, në nëntor të vitit 2006.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Rezerva e Qeverisë, shpenzimet e paparashikuara dhe barten në buxhetin e Sekretariatit të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, me seli në Sarajevë.
3. Obligohet Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/123

Datë: 05.04.2013

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2013, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet me vërejtje Rregullorja për strukturën organizative të Zyrës së Kryeministrit.
2. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për përfshirjen e vërejtjeve në tekstin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë